



Lënda: **Informacion dhe kërkesë për vetëdijësim e reflektim**

Mbi: **Ligjin 108/2018, "Për një shtesë në Ligjin Nr.8328, datë 16.041998 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të të paraburgosurve" dhe mënyrën e aplikimit të tij për herë të parë në burgun e sigurisë së lartë pranë IEVP "Jordan Misja", Tiranë**

Drejtuar: **Presidentit te Republikës  
Z. Ilir Meta**

**Kryetarit te Kuvendit  
Z. Gramoz Ruçi**

**Kryeministrit  
Z. Edi Rama**

Nga: **Av.Vladimir Meçi - mbrojtës dhe përfaqësues i Emiljano Shullazi**

Datë: **Tiranë, 12/08/2020**

---

*Të Nderuar,*

Fillimisht më lejoni t'Ju uroj shëndet dhe mirëqënie si fizike, ashtu edhe shpirtërore.

Edhe pse të nevojshme si kortezi, besoj se prezantimet e gjata janë të tepërta. Ju drejtohem në këtë letër, duke marrë shkas nga disa shqetësime serioze që më ka ngjallur Ligji 108/2018, "Për një shtesë në Ligjin Nr.8328, datë 16.041998 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të të paraburgosurve" (*i ashtuquajtur regjimi 41-bis*) dhe mënyra e aplikimit të tij për herë të parë ndaj të mbrojturit dhe përfaqësuarit prej meje Emiljano Shullazi.

Gjej me vend t'Ju bëj me dije se përfshirja ime dhe ngulmimi për të tërhequr vëmendjen Tuaj, buron nga besimi im parimor në respektimin e të drejtave të njeritit, si dhe të mbizotërimit të parimit të ligjshmërisë në cdo çështje, në mënyrë të tillë që si personat nën hetim apo gjykim, ashtu edhe qytetarët, të sigurohen që shteti i së drejtës dhe procesi i drejtë dhe i rregullt ligjor po respektohen.



Jam i qartë se në kohërat që po jetojmë, koncepte si ai të drejtave të njeriut, apo procesit të drejtë e të rregullt ligjor, mund të duken të mjegullta dhe gati gati kalorësiake, por nuk duhet të harrojmë se në fakt këto janë po aq natyrale sa vetë njeriu.

Sic e thotë më qartë Profesori i të Drejtës në Harvard, Alan Dershowitz: ***“Nuk ka drejtësi perfekte, ashtu si nuk ka etikë absolute. Por, ka padrejtësi perfekte, dhe kur ajo ndodh, ne e dallojmë qartë”***. Në rastin e regjimit 41-bis shqiptar dhe mënyrës se si ai po aplikohet ndaj të mbrojturit e përfaqësuarit prej meje Emiljano Shullazi, do të guxoja të thoja: Padrejtësia u bë shumë e madhe!

Më duhet të sjell në vëmendjen Tuaj, se edhe i pandehuri gëzon të drejtat e tij gjatë një procedimi apo gjykimi penal, të drejta të cilat janë të sanksionuara dhe te garantuara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, nga aktet ndërkombëtare ku vendi yne ka aderuar dhe nga ligjet e tjera që rregullojnë ecurinë e një procedimi penal.

Të gjithë jemi faktorë të ndryshëm në fushën e së drejtës, por që në thelb punojmë për një qëllim të përbashkët, atë të respektimit të ligjit dhe të zbatimit me rigorozitet te tij duke respektuar në cdo rast të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.

Një njeri pavarësisht se mund të jete i izoluar në burg, gëzon të njejtat të drejta si të gjithë njerëzit të cilët jetojnë jashtë burgut. Gjithashtu edhe ndërmjet vetë personave të izoluar në burg nuk mundet dhe nuk duhet të ekzistojë asnjë dallim përse i përket trajtimit të tyre.

Për një avokat është parësore dhe thelbësore që t'i ofrojë shërbimin e duhur dhe të kualifikuar ligjor personit që ai mbron, në respekt të dispozitave Kushtetuese e ligjeve të tjera që rregullojnë veprimtarinë e avokatit dhe të institucioneve shtetërore gjatë një procedimi penal.

Edhe institucionet shtetërore të zbatimit të ligjit, duhet të ushtrojnë detyrat e tyre funksionale duke pasur si parimin thelbesor të tyre mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave themelore te njeriut.

Transferimi i të mbrojturit dhe përfaqësuarit prej meje në këtë regjim, është bërë me anë të Urdhërit Nr.253, date 28.07.2020, të Ministrit të Drejtësisë, ***“Për Vendosjen në Rregjimin e Posaçëm të Ushtrimit të të Drejtave në Burgun e Sigurisë së Lartë për të Paraburgosurin Emiljano Shullazi”***.

Urdhëri i mësipërm i Ministrit të Drejtësisë është ekzekutuar në datën 01.08.2020 dhe i paraburgosuri Emiljano Shullazi si dhe avokati i tij mbrojtës, kanë marrë njoftim në të njëjtën datë.



Fillimi i zbatimit të këtij regjimi të posaçëm, i bazuar në ligjin 108/2018, "Për një shtesë në Ligjin Nr.8328, datë 16.04.1998 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të të paraburgosurve", u trumbetua si sukses në luftën kundër krimit të organizuar, por si ligji edhe zbatimi i tij, kanë nxjerrë në pah disa probleme të rëndësishme, për të cilat dëshiroj të tërheq vëmendjen Tuaj.

Urdhëri i Ministrit të Drejtësisë, si në formë edhe në përmbajtje është i kundraligjshëm, dhe abuziv dhe ne e kemi kundërshtuar tashmë gjyqësisht për këto kundraligjshmëri.

Nga ana tjetër, Urdhëri i Ministrit të Drejtësisë dhe mënyra se si ai po zbatohet, bie në kundërshtim me standartet dhe detyrimet që rrjedhin nga Aktet ndërkombëtare në të cilat Shqipëria është palë, si: Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, Konventa Evropiane për Parandalimin e Torturës dhe të Trajtimit ose Ndëshkimit Çnjerëzor ose Degradues si dhe me rekomandimet e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës për standartet e trajtimit në burgje dhe me rekomandimet e Komitetit për Parandalimin e Torturës si dhe me jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNj) në këtë lëmë.

Ligji 108/2018 i miratuar me urgjencë, ne vigjilje të ndrrimit të viteve, paraqet një sërë problemesh, të cilat do të pëpiqem ti trajtoj këtu më poshtë:

**Së pari**, Ligji 108/2018, është hartuar nën shembullin e legjislacionit Italian, për të ashtuquajturin "*burgim të rëndë*" dhe jo më kot ai edhe ne vendin tonë është quajtur ndryshe "*Regjimi 41-bis*".

Miratimi i këtij ligji, është bërë me ngutje dhe nuk janë mbajtur parasysh kritikata e shumta që ka marrë ligji Italian nga organizata prestigjioze "Amnesty International", nga Këshilli i të Drejtave të Njeriut i OKB, nga Komisioni për Parandalimin e Torturës i Bashkimit Europian dhe nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut.

Miratimi i ligjit Nr.108/2018, u krye në një kontekst krejt të ndryshëm nga ai në të cilin parlamenti Italian ne vitin 1986 miratoi ligjin e quajtur *41 bis* apo ndryshe dhe "*ligji i Gozzini*", nga emri i promovuesit të tij.

Sipas ligjit italian, regjimi i 41 bis fillimisht kishte të bënte vetëm me situata emergjente në burgje (*për shembull në rast trazirash*) dhe parashikonte pezullimin e zbatimit të "rregullave normale për trajtimin e të burgosurve", një pezullim ky "i motivuar nga nevoja" dhe brenda kufijve të "kohëzgjatjes rreptësisht të nevojshme".

Zgjerimi i regjimit 41 bis, daton që nga viti 1992, pas masakrës së Capaçit, në të cilën u vranë Giovanni Falcone, gruaja e tij dhe eskorta e shoqërimit. Atë vit, i ashtuquajturit dekret anti-mafia *Martelli-Scotti* u aprovua nga Këshilli i Ministrave dhe neni 41 bis (paragrafi i dytë), e shtriu veprimin për të arrestuarit mafiozë ose të dyshuarit si të tillë, të hetuar si pjesmarrës në organizata kriminale.

Dekreti, i cili u ndesh me mjaft kritika dhe dyshime për kushtetueshmerinë e tij, kishte si synim të parandalonte që bosët e organizatave kriminale të vazhdonin edhe në paraburgim që të urdhëronin pjestarët e organizatave kriminale që ata drejtonin, për të kryer vepra penale.

Një qëllim tjetër i ligjit Italian, ishte ai që të detyronte bosët mafiozë të bashkëpunonin me drejtësinë. E në këtë kohë, u miratuan dhe shtesa të ligjit të cilat bënë fjalë për bashkëpunëtorët e drejtësisë. Fillimisht me një natyrë të përkohshme, ligji bëhet përfundimtar në vitin 2002, vit në të cilin regjimi i burgut të ashpër shtrihet edhe për ata të dënuar për terrorizëm dhe subversion si dhe për disa krime të tjera të rënda.

Në vitin 2009, ligji "*Dispozitat për sigurinë publike*" përcaktoi që 41 bis mund të zgjatej për një periudhë në maksimum katër vjet, duke u realizuar kjo zgjatje çdo dy vjet. Ligji lejoi gjithashtu që të burgosurit mund të takonin fëmijët e tyre të moshës nën 12 vjeç pa një ndarje xhami.

Më në fund, në vitin 2017, u lëshua një qarkore që përmbante dhjetë rregulla për jetën e të burgosurve nën regjimin 41 bis. Përveç marrëdhënieve të të burgosurve me botën e jashtme dhe marrëdhënieve shoqërore në burg, u vendosën rregullat për rritjen e konfidencialitetit të të burgosurve, e drejta e tyre për të pasur libra dhe materiale të tjera për qëllime trajnimi dhe në fund detyrimin për drejtorët të burgut, për t'iu përgjigjur kërkesave të të burgosurve brenda një kohe të caktuar.

Sidoqoftë, Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në çështjet *Asciutto v. Italy* (2008), *Enea vs. Italy* (2009) *Provenzano v. Italy* (2013) *Marcello Viola v. Italy* (2019), ka mbajtur në mënyrë të vazhdueshme qëndrimin se ky regjim dhe mënyra e aplikimit të tij vjen ndesh me një sërë normash të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut. Jo vetëm kaq, por në vitin 2007, Gjykata e shtetit të Kalifornisë në SHBA, vendosi të refuzonte ekstradimin e Rosario Gambino në Itali, duke konkluduar që regjimi 41-bis përbën torturë dhe trajtim çnjerëzor.

Nga ana tjetër, ia vlen të përmendet se vërtet e kemi importuar nga Italia regjimin 41-bis, por Italisë i përket edhe filozofi/kriminologu/politikani Cesare Beccaria, i cili që në shekullin XVIII, ishte mjaftueshëm kurajoz për të folur kundër torturës, trajtimit çnjerëzor e degradues të të burgosurve, dhe mbi të gjitha kundër dënimit me vdekje që në atë kohë konsiderohej normal dhe i domosdoshëm për të frenuar krimin dhe kriminelët.

Duke u rikthyer në realitetin shqiptar, vendi ynë nuk mdodhet në atë situatë në të cilën ndodhej Italia, kur miratoi ligjin për regjimin e posaçëm.

Sistemi i burgjeve në Shqipëri, ka nevojë për t'u reformuar, madje ka nevojë për një reformë të thellë, që të mundësojë qëllimin e riedukimit dhe rehabilitimit të të burgosurve, me përgatitjen e tyre me qëllim që të integrohen pas vuajtjes së dënimit në shoqëri.

Nëse do të merret si shëmbull Italia, për garantimin në praktikë të të drejtave të të burgosurve edhe të atyre, të cilët ndodhen nën regjimin 41 bis, duhet të vendoset kontrolli i plotë gjyqësor mbi trajtimin e të burgosurve. Italia, në këtë drejtim, ka edhe struktura të posaçme, siç është ajo e Magjistratit Mbikqyrës apo edhe e Gjykatës Mbikqyrëse.

**Së dyti**, ishte e nevojshme që aplikimi me ligj i regjimit të posaçëm, të mbante parasysh edhe praktikën e konsoliduar tashmë të GJEDNJ, përsa i përket të drejtave të të burgosurve. Në Udhëzuesin e kësaj Gjykate, që bën fjalë për të drejtat e të burgosurve sipas çështjeve gjyqësore të shqyrtuara prej saj (*përditësuar më 30.04.2020*), ndër të tjera evidentohen këto çështje:

“Sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës, Konventa nuk ndalet te porta e burgut (*Khodorkovskiy dhe Lebedev kundër Rusisë, 2013, 36 836; Klibisz kundër Polonisë, 2016, 354*). Të burgosurit në përgjithësi vazhdojnë të gëzojnë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Konventë, përveç të drejtës së lirisë, ku burgimi është vendosur ligjërisht në përputhje me nenin 5 të Konventës.

Për shëmbull, të burgosurit nuk mund të keqtrajtohen, duke iu nënshtruar dënimit çnjerëzor ose poshtëruës ose kushte në kundërshtim me nenin 3 të Konventës; ata vazhdojnë të gëzojnë të drejtën për të respektuar jetën familjare; të drejtën për lirinë e shprehjes; të drejtën për të praktikuar fenë e tyre; të drejtën e një aksesit efektiv te një avokat ose një gjykatë për qëllimet e nenit 6; të drejtën për të respektuar korrespondencën (*Hirst kundër Mbretërisë së Bashkuar (nr. 2) [GC], 2005, § 69*).

Cdo kufizim i këtyre të drejtave të tjera duhet të jetë i justifikuar, megjithëse një arsytim i tillë mund të gjendet në konsideratat e sigurisë, të cilat në mënyrë të pashmangshme rrjedhin nga rrethanat e burgimit, veçanërisht për parandalimin e krimeve dhe trazirave. Sidoqoftë, nuk ka dyshim që një të burgosuri t'i vijë të mangëta të drejtat e tij sipas Konventës, thjesht për shkak të statusit të tij si një person i burgosur. (*Po aty, §§ 69-70*).

Parimi kryesor që mbështetet në praktikën gjyqësore të Gjykatës në lidhje me të drejtat e të burgosurve është domosdoshmëria e trajtimit të të gjithë personave të privuar nga liria me respektimin e dinjitetit të tyre dhe të të drejtave të njeriut.

Në të vërtetë, thelbi i sistemit të Konventës për mbrojtjen e të drejtave të njeriut bazohet në respektimin e dinjitetit njerëzor (*Bouyid kundër Belgjikës [GC], 2015, 89-90 §§*), i cili gjithashtu shtrihet edhe në trajtimin e të burgosurve (*Vinter dhe Të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar [GC], 2013, § 113*).

Ekziston veçanërisht një lidhje e fortë midis koncepteve të "trajtimit degradues" dhe respektimit të "dinjitetit" (*Bouyid kundër Belgjikës [GC], 2015, § 90*). Kështu, kur trajtimi fyen apo poshtëron një individ, duke treguar mungesë respekti ose cënuar dinjitetin e tij/saj njerëzor, ose ngjall ndjenja frike, ankthi ose inferioriteti duke thyer rezistencën morale dhe fizike të një individi, ai mund të karakterizohet si degradues dhe bije ndesh me ndalimet e nenit 3 (*Muršić kundër Kroacisë [GC], 2016, 98 §; Ananyev dhe të tjerët kundër Rusisë, 2012, § 140; Varga dhe të tjerët kundër Hungarisë, 2015, § 70*).

Shteti duhet të sigurojë që një person të burgoset në kushte që janë në përputhje me respektimin e dinjitetit njerëzor, dhe, mënyra e ekzekutimit të burgimit nuk duhet t'i shkaktojë atij/asaj shqetësime ose vështirësi të një intensiteti që tejkalon nivelin e pashmangshëm të vuajtjes në burg dhe që, duke pasur parasysh kërkesat praktike të burgimit, shëndeti dhe mirëqenia e tij/saj të jenë siguruar në mënyrën e duhur (*Kudła kundër Polonia [GC], 2000,-92-94; Idalov kundër Rusisë [GC], 2012, § 93; Muršić kundër Kroacisë [GC], 2016, 99 §*).

Gjykata gjithashtu ka konstatuar se është detyrë e Qeverisë së paditur të organizojë sistemin e saj të burgjeve në atë mënyrë që të sigurojë respektimin e dinjitetit të të burgosurve, pavarësisht nga vështirësitë financiare ose logjistike (*Muršić kundër Kroacisë [GC], 2016, § 99; Neshkov dhe të tjerët kundër Bullgarisë, 2015, 229 §*).

Në praktikën e saj gjyqësore në lidhje me të drejtat e të burgosurve sipas dispozitave të ndryshme të Konventës, Gjykata i kushton një theks të veçantë parimit të rehabilitimit, d.m.th., riintegrimin në shoqëri të një personi të dënuar (*Murray kundër Hollandës [GC], 2016, 101 §*).

Sidoqoftë, ajo vuri në dukje se dënimi mbetet një nga qëllimet e burgimit (*Po aty.*) dhe se funksioni thelbësor i një dënimi me burg është mbrojtja e shoqërisë, duke parandaluar një kriminel të kryejë përsëri krim duke shkaktuar kështu një dëm të mëtejshëm (*Mastromatteo v. Italia [GC], 2002, § 72*).

Në të njëjtën kohë, Gjykata njohu qëllimin legjitim të një politike të ri-integrimit shoqëror progresiv të personave të dënuar me burgim. Nga ky këndvështrim ajo pranoi meritat e masave - siç është lirimi i përkohshëm - duke lejuar ri-integrimin shoqëror të të burgosurve edhe kur ata janë dënuar për krime të dhunshme (*Po aty*)".

**Së treti**, ligji Nr.108/2018, me te cilin eshte shtuar neni 13/1 ne ligjin 8328, date 16.04.1998 “Per te Drejtat dhe Trajtimin e te Denuarve me Burgim dhe te Paraburgosurve”, është shkruar keq, ai krijon konfuzion dhe paqartësi për ata që duhet ta zbatojnë atë. Duke mos ndarë kategorinë e *personave të dënuar* nga kategoria e *personave që janë nën hetim apo gjykim*, ligji krijon hapësira për keqinterpretim dhe abuzim.

Duke analizuar dhe interpretuar nga pikpamja llogjike dhe gramatikore sa thuhet ne dispoziten e nenit 13/1 te ligjit (kriteri i percaktuar ne piken 3 të tij), rezulton se jo të gjithë të paraburgosurit që janë në fazën e hetimit dhe gjykimit, ende pa marrë formë të prerë vendimi ndaj tyre, e përmbushin kriterin për të qënë subjekte ndaj të cilëve mund të zbatohet regjimi i posaçëm, por vetëm ata të cilët kanë kryer veprat e renditura në dispozitën e sipërpërmendur, pra ato të parashikuara nga nenet “**79, shkronja “ç”, 79/a, 79/b, 230, 230/a, 230/b, 230/c, 230/ç, 231, 232, 232/a, 234, 234/a, 234/b, 283, paragrafi 3, 283/a, paragrafi 3, 284, paragrafi 3, 284/a, 284/c, paragrafi 3, 284/ç, paragrafi 3 të Kodit Penal, të kryera në kuadër të pjesëmarrjes në grup të strukturuar kriminal, organizatë kriminale, bandë të armatosur, organizatë terroriste ose për vepra me qëllime terroriste**”.

Nga interpretimi llogjik, dispozitat e neneve **333, 333/a** dhe **334** të Kodit Penal, nuk qendrojnë si kriter më vehte për personat që janë në fazë hetimi apo gjykimi ende të papërfunduar. Nuk ka kuptim te thuhet psh.: *Organizata kriminale (neni 333 i KP) e kryer në kuadër të pjesëmarrjes në grup të strukturuar kriminal, organizatë kriminale, bandë të armatosur, organizatë terroriste ose për vepra me qëllime terroriste!*

Po aq jo llogjike është edhe vendosja e nenit 333/a apo 334 të Kodit Penal përpara pjesës tjetër të fjalisë: “*te kryera në kuadër të pjesëmarrjes në grup të strukturuar kriminal, organizatë kriminale, bandë të armatosur, organizatë terroriste ose për vepra me qëllime terroriste*”.

Ligji është shprehje e koncentruar e llogjikës dhe jo i absurdit. E duke u kthyer ne analizen e sa më sipër, konstatojmë se ligjvënësi duke i përmbledhur në të njetin paragraf si kategorinë e të dënuarve ashtu dhe atë të personave në hetim apo gjykim, kur ka percaktuar veprat penale për të cilat mund të zbatohet regjimi i posacem, ka përdorur shprehjen **për këto vepra penale** dhe jo **për veprat penale**, duke e lidhur këtë me kategorinë e personave të dënuar apo që janë duke vuajtur dënimin në burgun e sigurisë së lartë.

Vetëm në këtë mënyre interpretimi, merr kuptim renditja e dispozitave te parashikuara nga nenet 333, 333/a te Kodit Penal. Pra, të denuarit të cilët kanë kryer qoftë edhe vetëm këto vepra penale (ato të parashikuara nga nenet 333, 333/a te Kodit Penal) bëjnë pjesë në kategorinë ndaj të cilëve mund të aplikohet regjimi i posaçëm.



Po kështu, përse i përket, dispozitës së nenit 334 të Kodit Penal, përsëri, duke i qëndruar interpretimit llogjik, kjo duhet të jetë e lidhur me veprat penale të parashikuara nga nenet 79, shkronja "ç", 79/a, 79/b, 230, 230/a, 230/b, 230/c, 230/ç, 231, 232, 232/a, 234, 234/a, 234/b, 283, paragrafi 3, 283/a, paragrafi 3, 284, paragrafi 3, 284/a, 284/c, paragrafi 3, 284/ç, paragrafi 3 të Kodit Penal dhe jo me cdo vepër tjetër penale.

Nuk do të kishte kuptim, psh. kundravajtja penale "plagosja e lehte me dashje", e parashikuar nga neni 89 i Kodit Penal, e kryer në kuader të grupit të strukturuar kriminal !!!

Arsyeja ligjore "*ratio legis*" për të vendosur një person në regjimin e posaçëm të burgut të sigurisë së lartë, apo siç quhet ndryshe regjimi 41-bis, bazohet në thelb nga nevoja për të penguar komunikimin e të burgosurve me botën e jashtme, për të parandaluar ata që konsiderohen "krere" të organizatave dhe grupeve kriminale që të krijojnë kontakte me organizatat kriminale që veprojnë në vend dhe për të penguar mundësinë e percjelljes së urdherave nga brenda burgut jashtë tij, për kryerjen e veprave penale apo për vazhdimin e aktivitetit kriminal në përgjithësi.

Për këtë qëllim, ligji parashikon një seri masash të zbatueshme për të burgosurit që i nënshtrohen regjimit të ashpër të burgut. Të "kufizuarit" në 41-bis vendosen në izolim, pra hiqen nga të burgosurit e tjerë që i nënshtrohen regjimit të zakonshëm, duke u vendosur në një qeli të vetme pa qasje në zona të zakonshme dhe monitorohen vazhdimisht nga një forcë speciale e policisë së burgut. Por kjo, vetëm pasi të jetë vërtetuar që i paraburgosuri të ketë kryer veprime të kundraligjshme, që synojnë në vijimin e aktivitetit kriminal për të cilin akuzohen.

Përveç kësaj, pengimi i këtyre subjekteve që të komunikojnë brenda dhe jashtë ambientit të burgut duhet domosdoshmërisht t'i lidhë komunikimet apo takimet me një aktivitet kriminal! Jo çdo komunikim apo takim përbën shkak për vendosjen e subjektit në regjimin e posaçëm. Në këtë pikë ligji është i paqartë!

**Se katerti**, ligji 108/2018 "**ndërhyn**" në Kodin e Procedurës Civile. Konkretisht, në nenin 13/1, në pikën 6 dhe 7 të tij parashikohet sa më poshtë:

*6. Kundër vendimit të Ministrit të Drejtësisë, për vendosjen apo zgjatjen e regjimit të posaçëm, i dënuari, i paraburgosuri apo avokati mbrojtës mund të paraqesin kërkesë ankimore brenda 20 ditëve, nga momenti i njoftimit të vendimit.*

*7. Kërkesa ankimore depozitohet në gjykatën e shkallës së parë kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, e cila është kompetente për gjykimin e çështjes, sipas parashikimit të nenit 480, të Kodit të Procedurës Penale. Gjykimi i çështjes nuk pezullon vendimin e Ministrit të Drejtësisë.*



Pra, ligji i jep kompetencë Gjykatës së Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar që të shqyrtojë ankesat e të dënuarve që vendosen në regjimin e posaçëm sipas parashikimeve të nenit 480 të Kodit të Procedurës Penale, e cila parashikon se:

#### **Neni 480 - Kompetenca të tjera**

- 1. Në fazën e ekzekutimit, gjykata është kompetente të vendosë për shuarjen e veprës penale pas dënimit, për shuarjen e dënimit, për dënimet plotësuese, për konfiskimin ose kthimin e sendeve të sekuestruara, si dhe për çdo rast të parashikuar me ligj.*
- 2. Kur vërtetohet shuarja e veprës penale ose të dënimit, gjykata e deklaron këtë edhe kryesisht, duke marrë masat përkatëse.*

Dispozita e nenit 480 të Kodit të Procedurës Penale, është e inkuadruar në Kreun II, të titulluar “Shqyrtimi nga gjykata i çështjeve që lidhen me ekzekutimin e vendimeve”.

#### **Neni 470 - Gjykata kompetente për ekzekutimin (Ndryshuar fjalë në pikën 1 e shfuqizuar pika 2 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)**

- 1. Gjykata e vendit të ekzekutimit është kompetente për shqyrtimin e kërkesave dhe pretendimeve që lidhen me ekzekutimin e tij.*
- 2. Shfuqizuar.*

Ne menyrë të veçantë për të dënuarit që i nenshtrohen regjimit të posaçëm, sipas Kodit të Procedurës Penale, kompetente për shqyrtimin e kërkesave dhe pretendimeve që lidhen me ekzekutimin e vendimeve me burgim, është gjykata e vendit të ekzekutimit.

Në rastin e regjimit të posaçëm, siç është deklaruar edhe nga Ministri i Drejtësisë, për të dënuarit, ky regjim do të zbatohet në IEVP Peqin. Kompetente sipas Kodit të Procedurës Penale, për shqyrtimin e ankesave që lidhen edhe me aplikimin e regjimit të posaçëm është Gjykata e rrethit gjyqësor Elbasan, ndërsa ligji 108/2018 e kalon këtë kompetencë në Gjykatën e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, **duke ndërhyrë dhe ndryshuar me një ligj të zakonshëm, një dispozitë të Kodit të Procedurës Penale.**

Me qëllim ilustrimin e problematikave të listuara më sipër, ia vlen ti rikthehemi mënyrës se si ky regjim u aplikua për herë të parë, pikërisht tek rasti “Shullazi”.

Ajo që thuhet në Urdherin e Ministrisë së Drejtësisë, për Emiljano Shullazin, se “*subjekti mban komunikime/kontakte me organizatën kriminale ku bën pjesë dhe me organizata të tjera, si dhe me të paraburgosurit e tjere, të cilët i perkasin se njejtës organizate dhe organizatave të tjera,*



*me te cilat bashkepunojne*”, eshte e paplote dhe nuk verteton qellimin e ketyre kontakteve apo komunikimeve.

Emiljano Shullazi, ka qene i paraburgosur ne IEVP 313, “Jordan Misja”, bashke me te kane qene ne te njejtin institucion edhe nipi i tij Endrit Zela, shoku i tij i feminise Gilmando Dani dhe kushuriri i tij Blerim Shullazi, te gjithë keta sipas gjykates se shkalles se pare “pjese e nje grupi te strukturuar kriminal”. Nese Ministri e ka fjalen per keta persona, te cilet “*jane pjese e se njejtës organizate kriminale*”, kujtojme se mes qenieve njerezore ka dhe marrëdhënie njerezore, daja do e takoje dhe do flase me nipin e tij, do kujdeset per te dhe kjo nuk mund te quhet as kriminale as e kundraligjshme.

Nëse Ministri e ka fjalen per “Organizata te tjera kriminale”, duhet të arsyetojë dhe të shprehet qartë se per cilat organizata e ka fjalen, a ka te tilla te proceduara penalisht apo edhe te denuara me vendim te formes se prere? Së fundmi, duhet te na thote se a kane patur keto komunikime dhe kontakte qellim kryerjen e veprave kriminale a terroriste ?

Sqarojme se Emiljano Shullazi, ka ne paraburgim plot 4 vjet e 3 muaj, ne dy vjet e gjysem ka qene edhe i punesuar ne Biblioteken e Burgut, nuk ka asnje verejtje apo mase disiplinore per shkelje te rregullores ndaj tij! Si ta shpjegojme qe ky individ, ka respektuar me perpikmeri rregulloren nga njera ane dhe nje dite te bukur me diell, si “rrufe ne qiell te paster”, u be “Armiku Publik” qe duhej patjeter te izolohej ne regjimin e posacem 41 bis?!

Po SPAK-u qe ben propozimin dhe ka dijeni per organizata te tjera kriminale, si nuk ka filluar asnje procedim ndaj tyre, pasi mjafton vetem krijimi dhe ekzistenca e tyre qe ato te procedohen penalisht?!

Gjithashtu, është shumë e rëndësishme të evdentohej se as personi në fjalë, dhe as të bashkëpandehurit e tjerë, nuk janë dënuar në shkallë të parë për asnjë nga veprat penale të listuara në pikën 3 të nenit 13/1, të kryera në kuadrin e organizatës kriminale. Nga veprat për të cilat ai është dënuar në shkallë të parë, dënimi maksimal i mundshëm rezulton të jetë 8 vjet, pra nuk kemi të bëjmë me ndonjë nga figurat e krimeve të rënda të parashikuara nga kjo dispozitë.

*Të nderuar,*

Pas parashtrimit të problematikave të lidhura me ligjin në fjalë, dhe me mënyrën se si ai ka filluar të aplikohet, vlerësoj se është e nevojshme që sa jemi ende në kohë të ketë një reflektim dhe të shqyrtohet mundësia si për rishikim të ligjit ashtu edhe për modalitetet e aplikimit të tij.



Nuk është asnjëherë e vonuar apo e tepërt, të pranohet që ekzistojnë mangësi në një proces të hartimit dhe zbatimit të ligjit, apo që nuk janë marrë në konsideratë Aktet dhe Marrëveshjet/Konventat ndërkombëtare në të cilat Shqipëria është palë me detyrimin për ti zbatuar dhe që sipas Kushtetutës, prevalojnë mbi të drejtën e brendshme.

Aq më tepër nuk është e vonuar apo e tepërt të rishikohet një gjendje e caktuar ligjore apo edhe e mënyrës së aplikimit të ligjit, kur kjo është në funksion të humanizmit, drejtësisë, barazisë para ligjit dhe distancimit nga politika që shpien në trajtime çnjerëzore, degraduese e me tipare të torturës.

Duke shprehur ne mirëkuptimin Tuaj, mbetem me shpresë për një reagim mbi sa më sipër.

Më lejoni, gjithashtu, t'Ju siguroj për konsideratën më të lartë.

Me respekt

Av. Vladimir Meçi



*P.S. Meqënëse Ligji 108/2018 për regjimin e posacëm dhe në mënyrë të vecantë mënyra se si ka filluar të zbatohet, ka ngjallur interes për publikun, çështjet e trajtuara në këtë letër do të ndahen edhe me publikun nëpërmjet mediave.*